



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.537/1 Prot.

Tiranë, më 27 / 04 / 2020

V E N D I M

Nr. 39 , Datë 27 / 04 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 138 Regj., datë 28.10.2019, të L.P, kundër Bashkisë së Gjirokastrës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, L. P shprehet se prej katër vitesh ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë e Gjirokastrës, në pozicionin “Përgjegjës Sektori” pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM). Ai citon se asnjëherë nuk ka marrë vërejtje lidhur me punën e kryer prej tij, deri me ardhjen në detyrë të Kryetarit të ri të Bashkisë, duke parashtruar se: “*Vetëm dy ditë pasi z.F. G mori detyrën në krye të Bashkisë Gjirokastrë, më ka dhënë vërejtjen e parë, për mosprezencë në punë, me datë 07.08.2019, ndërkohë që unë nëpërmjet procesverbalit vërtetoj që kam qenë në punë. Brenda dhjetë ditëve më jep vërejtjen e dytë “Paralajmërim për largim nga detyra”, për të cilën jam ndjerë i fyer dhe i diskriminuar nga Drejtori i ASHBVM-së. Këtë pretendim e lidh me faktin se ai urdhëroi nxjerrjen e një sasive drurësh në një largësi prej*

¹ Ankuesi provon bindjet e tij politike, nëpërmjet Kartës së Anëtarësisë në parti të politike “Lëvizja Socialiste për Integritet” (LSI), me nr.17336.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

800 m, në terren malor dhe transporti duhej bërë me krahë, gjë që nuk mund të realizohej nga unë dhe inspektorët e mi, pasi përveç pamundësisë fizike, kjo binte ndesh me Kodin e Punës dhe parashikimet e Rregullores. Nga ana e Drejtorit më është bërë vazhdimisht presion duke më kërkuar të paraqes dhe dorëheqjen. Me urdhërin nr.429, datë 23.10.2019 më kanë larguar nga detyra. Diskriminimi ndaj meje nga ana e drejtorit ka rënduar së tepërmi gjendjen time shëndetësore, për të cilën jam kuruar dhe në spital. Largimi nga puna më ka rënduar gjithashtu gjendjen ekonomike, pasi kam dhe gruan të papunë si dhe tre fëmijë në moshë shkollore. Kërkoj të ndërhyri në mënyrë të menjëhershme, pasi më kanë hequr nga puna vetëm për shkak të bindjeve të mija politike”.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, nga ana e punëdhënësit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.1642/2 prot., datë 06.11.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁴ Bashkisë Gjirokastrë, lidhur me pretendimin e ankuesit.
- Nëpërmjet shkresës me nr.8733/1 prot, datë 05.12.2019, Bashkia Gjirokastrë ka dërguar parashtrimet e veta dhe kopje të një pjese të dokumentacionit të kërkuar. Në parashtrimet e saj, Bashkia citon se:

“Ankuesi ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, (ASHBVM) Bashkia Gjirokastrë. Me anë të Urdhërit nr.317, datë 22.08.2019 ndaj L. P është marrë masa disiplinore “Vërejtje” si pasojë e mungesës në punë në datën 07.08.2019, ku gjatë kontrollit të ushtruar në zyrat e Agjencisë nga Kryetari i Bashkisë, në orën 12:30 nuk u gjend asnjë punonjës dhe dera e institucionit ishte e mbyllur. Si pasojë e kësaj sjelljeje të rëndë u largua nga puna Drejtori i Agjencisë dhe u vendosën masa disiplinore për të gjithë punonjësit. Me Urdhërin nr.41, datë 30.08.2019 të Drejtorit të ASHBVM, L. P i është dhënë masa disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna” për shkak të moskryerjes së detyrave të caktuara nga ligji dhe drejtuesit e Institucionit, dhe konkretisht duke mos zbatuar Urdhërin e Brendshëm nr.28, datë 20.08.2019 “Për inspektim në fondin pyjor” si dhe Urdhërin e punës nr.36, datë 29.08.2019. Këto dy urdhëra ju përcollën Bashkisë Gjirokastrë dhe u konfirmua me fotografi se në fondin pyjor të fshatit Fushëbardhë janë kryer dëme të mëdha dhe prerje të paligjshme. L. P si Përgjegjës i këtij Sektori nuk ka realizuar detyrat e tij të përcaktuara në ligj, duke shkelur detyrimet kontraktuale dhe duke i sjellë një dëm të madh dhe të pariparueshëm fondit pyjor të kësaj zone. Ai gjithashtu, nuk ka zbatuar dhe urdhërat e Drejtorit të Agjencisë. Në këto kushte, lidhur me këto shkelje, Bashkia Gjirokastrë me Urdhërin nr.360, datë 10.09.2019 i ka dhënë L. P masën disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”, me motivacionin për moszbatim të urdhërave të eprorit në mënyrë të përsëritur, gjë që ka sjellë dëme të rënda në realizimin e detyrave. Me shkresën nr.531 prot., datë 18.09.2019 të ASHBVM është propozuar largim nga puna për L. P, pasi nuk ka zbatuar Urdhërin nr.51 prot., datë 11.09.2019. Sërisht me shkresën nr.553 prot., datë 30.09.2019 të ASHBVM i është dërguar kërkesë e përsëritur Bashkisë Gjirokastrë, për largimin nga puna të

-
- ⁴Kopje të dosjes personale të L.P.(Emërime/kontrata pune/vlerësime performance,/masa disiplinore, nëse ka/Librezë Pune, etj)
 - Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e dy masave disiplinore ndaj ankuesit.
 - Kopje të Rregullores apo aktit ku përcaktohen detyrat e “Përgjegjës të Sektorit” dhe të “Inspektorit” të ASHBVM-së pranë Bashkisë Gjirokastrë.
 - Informacion nëse në vend të ankuesit është emëruar një punonjës/e tjetër.
 - Nëse po, një kopje e dosjes personale si dhe kopje të procedurës së ndjekur për emërimin e tij/saj.
 - Informacion nëse për të njëjtat shkelje janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.
 - Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të akteve.

L. P, pasi në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrat e ngarkuara nga ligji dhe Rregullorja e Brendshme e Agjencisë.

Gjithashtu, në bazë të kontrollit të Auditit të Brendshëm për menaxhimin e karburantit rezultoi se kishte një sërë shkeljesh nga ana e L. P, duke mos justifikuar një sasi të madhe karburanti. Në këtë rast kemi të bëjmë me shpërdorim detyre nga ana e punonjësit dhe për këtë arsye do të zhvillohet një auditim më i plotë për të konstatuar edhe problematika të tjera të mundshme.

Në lidhje me ecurinë e punës së L. P kanë ardhur një numër i lartë ankesash të banorëve të zonave, për keq menaxhimin e pyjeve dhe kullotave duke u ankuar në lidhje me kontratat e kullotave dhe zbatimin e tyre, çfarë ka sjellë konflikte të vazhdueshme midis blegtorëve. Nëpërmjet shkresës nr.7422 prot., datë 03.10.2019 L. P është njoftuar për fillimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës dhe i është lënë takim për të paraqitur prapësimet në datën 08.10.2019”.

Ndërkaq, në përgjigjen e Bashkisë Gjirokastër citohet se prapësimet e L. P janë paraqitur nëpërmjet procesverablit me nr.210 prot., datë 09.10.2019. L. P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Gjirokastër, është liruar nga ky pozicion pune, me Urdhërin nr.429, datë 23.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, për shkaqet sipër përmendur.

Në konkluzion të parashtrimeve të saj, Bashkia Gjirokastër ka theksuar se, subjekti ankues nuk është diskriminuar për bindjet e tij politike, por ai me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shkaktuar pamundësinë e Bashkisë, për të përmbushur funksionet e parashikuara në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe në ligjin nr.9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimn pyjor”, të ndryshuar, duke sjellë në këtë mënyrë pasoja shumë të rënda, me faj të tij, në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Administrimit Pyjor pranë ASHBVM, në mënyrë konstante dhe të përsëritur gjatë muajve Gusht-Shtator 2019.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së L. P, Komisioneri me datë 28.01.2020⁵ realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueseve me autorizim⁶ të Bashkisë Gjirokastër, znj.N. Sh dhe znj.A.Ll.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen dhe në vijim të vendimit. U ra dakord që secila nga palët që ka dokumentacion, prova apo parashtrime të reja lidhur me pretendimet e tyre, t'i depozitojë pranë KMD-së në vijim.

Ndërkaq, në vijim të seancës dëgjimore, Bashkia Gjirokastër, nëpërmjet shkresës me nr.309/1 prot., datë 03.02.20120 informoi KMD se: *“Punonjësve të cilëve u është lidhur marrëdhënia e*

⁵ Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr.54 prot., datë 13.01.2020, të Komisionerit.

⁶ Referuar Autorizimit me nr.693 prot., datë 27.01.2020, të Drejtorit të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër.

punës më Kod Pune nuk u janë bërë vlerësime performnce”, si dhe bashkëlidhur ka dërguar kopje të Urdhërit të emërimit të Drejtorit të ASHBVM, z.S.R.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi.

a) Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi, përsa i takon masave disiplinore të dhëna ndaj tij.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Gjirokastrë, me datë 11.04.2016, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM), Agjenci në varësi të Bashkisë Gjirokastrë, nëpërmjet Urdhërit nr.250, datë 11.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë. L. P ka qenë në marrëdhënie pune deri me datë 23.10.2019, datë në të cilën është bërë dhe lirimi i tij nga detyra, nëpërmjet Urdhërit nr.429, datë 23.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë.

Referuar akteve shkresore të dosjes së ankuesit, rezulton se ndaj tij, vetëm për periudhën: gushtetor të vitit 2019, janë dhënë katër masa disiplinore (përfshirë edhe largimin nga detyra), ndërkohë që për periudhën e mëparëshme të punës nuk rezultojnë masa disiplinore ndaj tij. Kështu:

- Me Urdhërin nr.317, datë 22.08.2019 të Kryetarit të Bashkisë i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, me motivacionin për shkak të mungesës në punë në datën 07.08.2019.

Megjithëse është kërkuar shkresërisht nga KMD disa herë, që të sillej e gjithë procedura e ndjekur për marrjen e masave disiplinore ndaj ankuesit, Bashkia Gjirokastrë:

- Lidhur me masën e parë disiplinore, ka vënë në dispozicion vetëm Urdhërin nr.317, datë 22.08.2019 dhe procesverbalin⁷ e konstatimit të mungesës së gjithë punonjësve të Agjencisë në vendin e punës, në datë 07.08.2019, ora 12:30, firmosur nga Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Kabinetit dhe Specialistja e Burimeve Njerëzore.

⁷ Protokolluar me nr.5784 prot., datë 08.08.2019.

- Ndërkaq, vërehet se masa disiplinore sa më sipër i është komunikuar L.P me datë 10.10.2019, datë në të cilën dhe ka paraqitur kundërshtitë dhe observacionin e tij lidhur me rastin. Ai nuk ka patur dijeni më përpara dhe aq më tepër të ishte njohur me të dhe të kishte patur mundësinë ta kundërshtonte atë.

Nëpërmjet shkresës me nr.214 prot., datë 10.10.2019, ankuesi ka paraqitur observacion, nëpërmjet të cilit kundërshton këtë masë disiplinore si të padrejtë dhe të qëllimshme ndaj tij, duke argumentuar dhe faktuar se:

- Nëpërmjet procesverbalit nr.86 prot., datë 08.08.2018 dhe sistemit të sigurisë/ kamerave të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Gjirokastër ankuesi provon se me këtë datë ka qenë në Komisarariat, për të dëshmuar lidhur me konfliktin e krijuar me datë 07.08.2019 midis dy fermerëve në fshatin Golem. Ankuesi shprehet se është njoftuar nga Inspektori i Policisë së Njësisë Administrative Picar, z.H.Z dhe Oficeri i Policisë Kriminale z.D.B për t'u paraqitur pranë Komisarariatit, për t'u pyetur rreth këtij konflikti.
- Nëpërmjet procesverbalit nr.86 prot., datë 08.08.2019, pasqyrohet ngjarja e ndodhur me datë 07.08.2019 në Gjirokastër, midis palëve: z.I.Rr dhe z.A.B, banues në fshatin Golem, mbi konfliktin e krijuar për burimin e ujit ku pinin bagëtitë. Në vendngjarje⁸ kanë qenë të pranishëm dy personat e konfliktuar dhe dy përfaqësues të ASHBVM: inxhinieri i Agjencisë, z.A.K dhe subjekti ankues.
- Nga ana e Bashkisë Gjirokastër nuk u soll asnjë provë që të vërtetonte të kundërtën, pra pretendimi i ankuesit lidhur me prezencën e tij në Komisarariat, faktohej dhe ishte i vërtetë.
- Bashkia nuk provoi që ankuesi të ishte njoftuar lidhur me masën disiplinore dhe që atij t'i ishin vënë në dispozicion provat bashkëlidhur, apo që t'i ishin krijuar mundësitë për t'u dëgjuar dhe mbrojtur për masën e dhënë disiplinore.
- Nga ana tjetër, Bashkia Gjirokastër nuk rezulton që, edhe pas observacionit të paraqitur nga ankuesi dhe provave të tij që faktein haptazi arsyen e mosprezencës në vendin e punës me datë 07.08.2019; ta ketë marrë në konsideratë atë, të paktën për të konstatuar nëse pretendimet dhe faktet e paraqitur nga ankuesi qëndronin apo jo.

Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, Komisioneri gjykon se nga ana e Bashkisë Gjirokastër është shkelur e drejta e ankuesit për të patur një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur ndaj masës së dhënë, duke bërë që ky proces të jetë krejtësisht njëanshëm dhe i padrejtë nga ana e Bashkisë.

- Lidhur me masën e dytë disiplinore, Komisioneri vëren se, rreth një javë pas dhënies së masës së parë disiplinore, ankuesit i është dhënë një masë tjetër disiplinore.

Me Urdhërin nr.41, datë 30.08.2019 ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna”, nga Drejtori i ASHBVM, me motivacionin “Shpërdorim detyre, shkelje e rëndë e akteve ligjore dhe nënligjore dhe moszbatim i urdhërave të lëna në ngarkim nga Drejtori”. Në përmbajtje të aktit citohet se ankuesi, në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit nuk ka zbatuar Urdhërin nr.28, datë 20.08.2019 dhe Urdhërin nr.36, datë 29.08.2019, të Drejtorit të ASHBVM.

⁸ Siç rezulton dhe nga procesverbali i mbajtur dhe firmosur prej secilit prej tyre.

Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, Komisioneri vëren se nuk do të merret me analizimin e “masës” në vetvehte, pasi ky akt/ Urdhëri nr.41, datë 30.08.2019 i Drejtorit të ASHBVM, është një akt administrativ jo vetëm i paligjshëm por dhe nul; pasi është dhënë në kapërcim të tagrave ligjorë dhe kompetencës që ka titullari i Agjencisë, që në rastin konkret është dhe eprori direkt i Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Drejtori në asnjë rast nuk mund të marrë atributet e punëdhënësit, Kryetarit të Bashkisë, për dhënien e masës disiplinore. Një parashikim i tillë, në terma të përgjithshëm përcaktohet në nenin 37⁹, të Kodit të Punës.

- Lidhur me masën e tretë disiplinore, Komisioneri vëren se, ankuesit, 10 ditë pasi ka marrë masën disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna”, nga Drejtori i ASHBVM, me Urdhërin nr.360, datë 10.09.2019 të Kryetarit të Bashkisë i është dhënë sërish e njëjta masë disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna”, me motivacionin “*Për shkak të shkeljeve të rënda në zbatimin e detyrave, moszbatim i urdhërave të eprorit në mënyrë të përsëritur çfarë ka sjellë dëme të rënda në funksionimin e punës*”.

Kjo masë disiplinore në thelb u referohej problematikave të trajtuara në masën e dytë disiplinore të Urdhërit nr.41, datë 30.08.2019 të Drejtorit të ASHBVM. Kryetari i Bashkisë, në tagrin e punëdhënësit, së pari, do të duhej të shprehej se Urdhëri sipërcituar i Drejtorit ishte një akt nul dhe për këtë shkak kishte iniciuar ecurinë disiplinore ndaj ankuesit, mandej së dyti, do të duhej të provonte se ishte zbatuar me korrektesë e gjithë procedura ligjore që do t’i garantonte ankuesit një proces të rregullt, të drejtë dhe ligjor, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur ndaj masës së dhënë.

Bazuar në parimin “*non bis in idem*”, parim i mosndëshkueshmërisë më shumë se një herë për të njëjtat fakte, Komisioneri vlerëson se punëdhënësi nuk mund t’u referohej sërish të njëjtave fakte të cilat kanë shërbyer për dhënien e masës së parë disiplinore, për të dhënë dhe një masë të dytë.

Nuk është depozituar (megjithëse është kërkuar kopje e gjithë procedurës së ndjekur për ecurinë e dhënies së masës disiplinore ndaj ankuesit) asnjë akt shkresor ku të rezultojë se nga ana e Bashkisë Gjirokastër të jetë ndjekur një procedurë e ligjshme ndaj ankuesit. I njëjti konkluzion vjen dhe në rastet e dhënies së dy masave të tjera disiplinore ndaj tij.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe të paligjshëm.

Kodi i Procedurës Administrative¹⁰ dhe Kodi i Punës, i ndryshuar¹¹, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast

⁹ Masat disiplinore.

¹⁰ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

¹¹ Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: “10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.

Bashkisë Gjirokastër, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për çdo pretendim të ankuesit dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura.

Nga ana e Bashkisë Gjirokastër nuk u soll procedura e ndjekur prej tyre lidhur me masën e tretë disiplinore ndaj ankuesit: njoftimi që ai të kishte të kishte patur mundësi për t’u dëgjuar dhe kundërshtuar atë. Fakti që një procedurë e tillë nuk është aplikuar dhe në këtë rast nga Bashkia, provohet nëpërmjet kërkesës me nr.6724 prot., datë 13.09.2019 që ankuesi ka paraqitur pranë saj, duke kërkuar të njihet me procesverbalët e konstatimit të shkeljeve të pretenduara nga Institucioni kundrejt tij.

Komisioneri vlerëson se dhënia e masës së tretë disiplinore ndaj ankuesit dhe shkelja në mënyrë të përsëritur e së drejtës për proces të rregullt dhe të drejtë, ligjor për t’u mbrojtur, nga ana e Bashkisë, përforcon dyshimin se ndaj tij ka patur një tendencë dhe se këto masa kanë patur për qëllim për t’i paraprirë largimit të tij nga puna.

Në konkluzion të sa mësipër, Bashkia Gjirokastër dështoi të provojë sërish, se dhënia e kësaj mase disiplinore është bërë në respektim të parimit të së drejtës së punonjësit për një proces të rregullt ligjor gjatë procedurës disiplinore të ndërmarrë ndaj tij, apo të akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me të.

- Lidhur me masën e katërt disiplinore, Komisioneri konstaton se, nëpërmjet Urdhërit nr.429, datë 23.10.2019 “Për lirim nga detyra” të Kryetarit të Bashkisë, ankuesi është liruar nga pozicioni i punës Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave/ASHBVM.

Arsyetimi për largimin e tij nga puna ishte se ankuesi: *“Veprimet dhe mosveprimet e tij kanë shkaktuar pamundësinë e Bashkisë Gjirokastër për të përmbushur funksionet e parashikuara në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.9385/2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, duke sjellë në këtë mënyrë pasoja shumë të rënda, me faj të rëndë të*

Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit Pyjor pranë ASHBVM, në Bashkinë Gjirokastrë, në mënyrë konstante dhe të përsëritur gjatë muajve Gusht e Shtator 2019”.

Në pjesën konstatuese të këtij Urdhëri janë cituar rishtaz të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj ankuesit, të cilat janë cituar më lart në vendim, si dhe bëhet një përshkrim i kërkesave të përsëritura nga ASHBVM për largimin e tij nga puna. Kështu, nëpërmjet shkresës me nr.531 prot., datë 18.09.2019 të ASHBVM është propozuar pranë Bashkisë largimi i ankuesit nga puna, për moszbatim të Urdhërit nr.51 prot., datë 11.09.2019 të Drejtorit të ASHBVM, si dhe të detyrave të lëna për periudhën 02.09.2019-06.09.2019.

Nëpërmjet shkresës me nr.553 prot., datë 30.09.2019 të ASHBVM është dërguar kërkesë e përsëritur për largimin e tij nga puna, për moszbatim në mënyrë të përsëritur të detyrave të ngarkuara.

Arsyetimi për largimin e ankuesit nga puna, nga ana e Bashkisë, vijon duke shtuar një pretendim i ri, i cili në fakt nuk rezulton që më përpara t'i jetë bërë i ditur ankuesit dhe që konsiston në evidentimin nga ana e Auditit të Brendshëm të Bashkisë të faktit se L.P nuk justifikon një sasi të madhe karburanti. Në Urdhërin e largimit të tij nga puna, Bashkia ka cituar se ankuesi ka shpërdoruar detyrën. Po ashtu, Urdhëri citon se ndaj ankuesit ka patur një numër të lartë ankesash nga banorët e zonave për keqmenaxhim të kullotave, gjë që ka sjellë dhe konflikte të vazhdueshme mes blegtorëve.

Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, Komisioneri analizon kronologjinë e ngjarjeve dhe fakteve si më poshtë:

Së pari, lidhur me propozimin e Drejtorit të ASHBVM drejtuar Kryetarit të Bashkisë nëpërmjet shkresës me nr.531 prot., datë 18.09.2019, për largimin nga puna të L.P.

Sa i takon pretendimit për moszbatim të Urdhërit nr.51, datë 11.09.2019 të Drejtorit të ASHBVM, si dhe të detyrave të lëna për periudhën 02.09.2019-06.09.2019, Komisioneri vlerëson se, këto pretendime nuk qëndrojnë dhe janë të paprovuara:

- Referuar procesverbalit nr.174 prot., datë 13.09.2019 të mbajtur nga subjekti ankues, për raportimin e detyrave të lëna në Urdhërin sipërcituar evidentohet se është bërë një përshkrim i përgjithshëm i detyrave të caktuara për këtë Sektor dhe janë bashkëlidhur raportet specifike nga secili inspektor i Sektorit: N.SH, E.L, A.K, G.K, L.Ç, V.B.
- Po ashtu, në observacionin me nr.214 prot., datë 10.10.2019 të subjektit ankues evidentohet fakti që raportimi i kërkuar është paraqitur në kohë dhe i plotë.
- Nga ana e Bashkisë nuk u dha asnjë argumentim apo provë ku të faktohej se raportimi nuk ishte i plotë apo sipas kërkesave të Drejtorit, megjithë kërkesën e Komisionerit për të evidentuar se çfarë konkretisht nuk ishte zbatuar apo raportuar në mënyrën e kërkuar dhe cila ishte mënyra që duhej paraqitur raportimi (formati apo kërkesat e raportimit).
- Për më tepër, përsa kohë nuk u provua e kundërta, krijohet bindja që dhe raportimet e mëparëshme nga ana e këtij Sektori, duhet të jenë paraqitur në këtë mënyrë dhe në këtë lloj formati.

Megjithë kërkesat e Komisionerit drejtuar Bashkisë për të argumentuar se si duhet të prezantohej një raportim, nëse kishte një format të caktuar nga ana e drejtuesve të Agjencisë, nuk u soll asnjë parashtrim apo akt shkresor në cilësi prove.

Së dyti, lidhur me propozimin e Drejtorit të ASHBVM drejtuar Kryetarit të Bashkisë nëpërmjet shkrësës me nr.553 prot., datë 30.09.2019, për largimin nga puna të L.P.

Për herë të dytë është kërkuar sërish që ndaj ankuesit të merrej masa e largimit nga detyra, për shkak të moszbatimit të Urdhërit nr.51, datë 11.09.2019, sipërcituar.

Sa i takon pretendimit për moszbatim të Urdhërit nr.61, datë 23.09.2019 të Drejtorit të ASHBVM, Komisioneri vlerëson se, këto pretendime nuk qëndrojnë dhe janë të pa provuara:

- Referuar procesverbalit nr.190 prot., datë 27.09.2019 të mbajtur nga grupi i inspektimit (L.Ç, V.B dhe subjekti ankues), për raportimin e detyrave të lëna në Urdhërin sipërcituar evidentohet se është bërë një përshkrim i hollësishëm i secilës nga detyrat duke u faktuar me foto të realizuara në vend.
- Nëse do të kishte patur dyshime për fallsifikim apo manipulim të fakteve dhe rrethanave, Bashkia Gjirokastrë duhet të kishte ndërmarrë masat konkrete për të faktuar një dyshim të tillë. Për sa kohë një hap i tillë nuk është ndërmarrë nga ana e Bashkisë dhe as janë sjellë prova për të faktuar pretendimet e tyre, Komisioneri vlerëson se, ajo nuk duhet të ishte bazuar mbi këto pretendime për të iniciuar në vijim procedurën për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.

Bazuar në kronologjinë e masave disiplinore të dhëna ndaj ankuesit, Komisioneri krijon dyshim të arsyeshem se këto masa kanë qenë tendencioze përkundrejt ankuesit.

Së treti, lidhur me procedurën e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës me ankuesin nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, Komisioneri pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e sjellë ka evidentuar se:

- Nëpërmjet shkrësës me nr.7422 prot., datë 03.10.2019 Bashkia Gjirokastrë ka njoftuar ankuesin për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr.429, datë 23.10.2019 “Për lirim nga detyra”, ankuesi është larguar përfundimisht nga puna.

Të dyja këto shkresa i referohen në mënyrë të përmblodhur të gjitha masave disiplinore sipërcituar, duke cituar dhe moszbatimin e Urdhërave respektivë të Drejtorit të ASHBVM, por pa bashkëlidhur asnjë dokumentacion provues lidhur me secilin rast:

- Moszbatim i Urdhërit të punës nr.28, datë 20.08.2019.
- Moszbatim i Urdhërit të punës nr.36, datë 29.08.2019.
- Moszbatim i Urdhërit të punës nr.51, datë 11.09.2019.
- Moszbatim i Urdhërit të punës nr.61, datë 23.09.2019.
- Moszbatim të detyrave të lëna për periudhën 02.09.2019-06.09.2019.
- Po ashtu citohet se ankuesi ka shpërdoruar detyrën, pasi nuk ka justifikuar një sasi të madhe karburanti.

Referuar procesverbalit me nr.210 prot., datë 09.10.2019 evidentohet fakti se nga ana e Drejtorit të ASHBVM i është parashtruar ankuesit se ai nuk kishte zbatuar urdhërat e punës sipërcituar. Ankuesi ka kundërshtuar të gjitha pretendimet për mospërbushje të detyrave nga ana e tij, duke argumentuar secilin rast. Po ashtu, referuar procesverbalit me nr.214 prot., datë 10.10.2019 janë argumentuar në mënyrë të detajuar nga ankuesi, masat e marra prej tij për zbatimin e secilit urdhër pune, duke parashtruar fakte për secilin rast, sikurse dhe janë shtjelluar më sipër¹². Komisioneri ka shprehur qëndrimin e tij lidhur me secilën nga masat disiplinore të dhëna ndaj ankuesit.

Lidhur me pretendimin e Drejtorit të ASHBVM për moszbatim të Urdhërit të tij të punës nr.36, datë 29.08.2019, i cili ka shërbyer dhe si motivacion për dhënien e masës së dytë dhe të tretë disiplinore ndaj ankuesit¹³, Komisioneri vlerëson të rëndësishme të theksojë se:

- Urdhëri i punës me nr.36, datë 29.08.2019, i Drejtorit të ASHBVM ka përcaktuar grupin e punës prej 8 (tetë) inspektorësh, ndër të cilët edhe ankuesi.
- Nëpërmjet tij urdhërohej grupi i punës për të realizuar transportin e 3m³ lënde drusore, e cila ishte sekuestruar me datë 28.08.2019 në parcelën nr.68, fshati Shtëpëz, në një distancë rreth 300-400 m.
- Sikurse pasqyrohet në procesverbalin e datës 10.10.2019 me nr.214 prot., lënda drusore ishte sekuestruar nga grupi i inspektimit (L.Ç, G.K dhe subjekti ankues) me datë 28.08.2019, ora 19⁰⁰, fakt ky i pranuar dhe i pakundërshtuar nga përfaqësuesit e Bashkisë Gjirokastër¹⁴ dhe të nesërmen u ishte komunikuar shkresërisht të transportohej pa specifikuar mënyrën apo mjetet me të cilat duhej realizuar. Ankuesit dhe dy inspektorëve të tjerë u është komunikuar verbalisht që transportin e lëndës drusore duhej ta realizonin me krahë. Referuar deklarimeve të ankuesit, kjo gjë nuk mund të realizohej pasi terreni ishte shumë i thepisur, distanca reale ishte rreth 700-800 m. Ky fakt nuk u kundërshtua nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë.
- Lidhur me sa mësipër, nga ana e Bashkisë nuk u soll asnjë akt ligjor/nënligjor ku të parashikohej realizimi i transportit të lëndës drusore të sekuestruar, apo ndonjë praktikë e ngjashme kur inspektorët të kishin realizuar personalisht dhe fizikisht transport të lëndës drusore, me krahë, megjithëse ishte kërkuar nga ana e Komisionerit. Përfaqësueset e Bashkisë Gjirokastër, deklaruan se në raste analoge më përpara, një situatë e tillë ishte zgjidhur duke kontaktuar banorë të zonës të cilët dispononin kafshë transporti, por që në rastin konkret nuk u mundësua dhe u ngarkuan inspektorët. Ata pohuan se në asnjë rast tjetër më përpara nuk ishte realizuar nga inspektorët personalisht, bartja fizike me krahë e lëndës drusore të sekuestruar.
- Referuar përcaktimit të detyrave funksionale të Përgjegjësit të Sektorit të Administrimit Pyjor pranë ASHBVM, në Rregulloren e brendshme bazë “Për organizimin, funksionimin dhe detyrat në ASHBVM”, në asnjë pikë të saj nuk është i parashikuar një detyrim i tillë.

¹² Nga faqja 6-10 e vendimit :...*”lidhur me masën e parë, masën e dytë, masën e tretë dhe masën e katërt disiplinore”*.

¹³ Fakt i cili nuk është argumentuar më parë në vendim.

¹⁴ Referuar pohimeve dhe deklarimeve të përfaqësuesesve të Bashkisë Gjirokastër gjatë sences dëgjimore datë 28.01.2020.

Neni 8 i kësaj Rregulloreje ka të përcaktuar shprehimisht: “ *Përgjegjësi i Sektorit ka këto detyra:*

- a) Merr masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo zyrë, punonjës në veçanti dhe si Sektor brenda planifikimit të detyrave të Agjencisë;*
- b) Evidenton problemet që dalin nga veprimtaria e përditshme si dhe çështjet e ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon Drejtorit rrugëzgjdhjet përkatëse;*
- c) Kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi, për plotësimin e detyrave që u janë ngarkuar;*
- d) Kryen studime për fusha të ndryshme dhe organizon sistemin e informacionit për Sektorin që mbulon;*
- e) Organizon sistemin e administrimit të informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e Sektorit”.*

Pra, sikurse shihet qartë, ankuesi është ngarkuar për realizimin e një detyre e cila nuk bën pjesë në detyrat e tij funksionale, në kundërshtim me parashikimet e Rregullores së Brendshme të ASHBVM, si dhe aktet e tjera ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës, siç është dhe kontrata individuale e punës.

- Nga ana tjetër, Komisioneri vlerëson se inspektorët, përfshirë dhe ankuesin, janë urdhëruar të realizojnë një punë që ata nuk kanë trajnimin e duhur për ta realizuar, transportin fizik të lëndës drusore në një terren të thepisur dhe në distancë prej rreth 700 m, duke rrezikuar dhe shëndetin e tyre, si pasojë e ndonjë dëmtimi të mundshëm fizik.

Urdhëri i sipërcituar bie në kundërshtim dhe me parashikimet e Kodit të Punës, i cili në nenin 23 të tij, ka përcaktuar se: “*Punëmarrësi nuk është i detyruar të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, që ndryshojnë kushtet e kontratës së punës. Ndryshimi i kontratës bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve. Punëmarrësi nuk është i detyruar të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tij”.*

Lidhur me pretendimin e Bashkisë Gjirokastër se: “*Ndaj L. P kanë ardhur një numër i lartë ankesash të banorëve të zonave, për keq menaxhimin e pyjeve dhe kullotave duke u ankuar në lidhje me kontratat e kullotave dhe zbatimin e tyre, çfarë ka sjellë konflikte të vazhdueshme midis blegtorëve”*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim rezulton i pa provuar pasi:

- Nga Bashkia Gjirokastër nuk është sjellë asnjë provë për dokumentimin e ankesave të këtyre banorëve, megjithëse një gjë e tillë është kërkuar shprehimisht nga Komisioneri.

Lidhur me pretendimin e Bashkisë Gjirokastër se: “*Në bazë të kontrollit të Auditit të Brendshëm për menaxhimin e karburantit rezultoi se kishte një sërë shkeljesh nga ana e L. P, duke mos justifikuar një sasi të madhe karburanti. Në këtë rast kemi të bëjmë me shpërdorim detyre nga ana e punonjësit”*, Komisioneri vlerëson se dhe ky pretendim nuk qëndron pasi:

- Bashkia Gjirokastrë nuk solli asnjë dokument ku të rezultonte se pretendimi është i bazuar në fakte dhe prova. Nuk u specifikua se sa ishte sasia e tejkaluar apo shpërdoruar e karburantit nga ana e ankuesit. Nga ana tjetër nuk solli asnjë parashtrim se përse nuk ishin marrë në konsideratë argumentimet e ankuesit, i cili në observacionin e tij të datës 10.10.2019 si dhe gjatë seancës dëgjimore pranë Zyrës së KMD, theksoi se të gjitha lëvizjet me automjet për efekt pune janë të dokumentuara me urdhëra pune të Drejtorit dhe fletë-udhëtime të dorëzuara personit përgjegjës.

Lidhur me pretendimin e Bashkisë Gjirokastrë se ankuesi: *“Me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shkaktuar pamundësinë e Bashkisë, për të përmbushur funksionet e parashikuara në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe në ligjin nr.9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, duke sjellë në këtë mënyrë pasoja shumë të rënda, me faj të tij, në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Administrimit Pyjor pranë ASHBVM, në mënyrë konstante dhe të përsëritur gjatë muajve Gusht-Shtator 2019”,* Komisioneri ka kërkuar prej Saj të specifikojë konkretisht se cilat ishin pasojat shumë të rënda, sikurse është cituar në shkresën me nr.8733/1 prot., datë 05.12.2019, që për fajin e rëndë të ankuesit kanë shkaktuar pamundësinë e Bashkisë Gjirokastrë, për të përmbushur funksionet e saj në respektim të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe ligjit “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”.

- Lidhur me sa mësipër, nga Bashkia Gjirokastrë nuk është sjellë asnjë parashtrim apo argument për të faktuar një pretendim të tillë dhe për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe nuk qëndron.

Referuar kronologjisë së gjithë masave disiplinore të dhëna ndaj ankuesit për periudhën kohore Gusht-Tetor 2019, Komisioneri ka vlerësuar se ato kanë qenë të pa argumentuara, të pa provuara dhe se ankuesit në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur i është mohuar e drejta e tij për një proces të rregullt ligjor, e drejta për t’u njohur me aktet në të cilat pretendoheshin shkeljet e bëra prej tij, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur.

Dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t’i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës, si dhe për faktin se masat disiplinore më të lehta parashkruhen me kalimin e afateve të caktuara ligjore.

Nëse procedura e njoftimit apo e masës disiplinore do të respektohet, atëherë pa diskutim që punëdhënësi ka të drejtë ta përshkallëzojë dhënien e masës deri në ekstremin e saj. Në të kundërt, nëse punëdhënësi nuk e provon këtë gjë, atëherë ai mund të abuzojë me preteksin e shkeljes së disiplinës për të pushuar nga puna çdo punëmarrës.

Referuar barrës së provës sikurse është cituar dhe më lart në vendim, Bashkia Gjirokastrë, si subjekt nga i cili është pretenduar diskriminimi, duhet të provonte se ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të paligjshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se largimi i ankuesit nga puna, të kishte ardhur për arsye të ligjshme apo të ishte i arsyeshëm dhe i justifikuar.

Bashkia Gjirokastrë jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm, por shpjegimet e dhëna prej saj, janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁵, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

¹⁵ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, Komisioneri gjykon se “bindjet politike” konsiderohen si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Nëpërmjet Kartës së Anëtarësisë në partinë politike “Lëvizja Socialiste për Integrim” (LSI), me nr.17336, subjekti ankues, vërteton bindjet dhe angazhimin e tij politik, si anëtar i këtij subjekti politik.

Nëpërmjet Urdhërit nr.429, datë 23.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, z.F.G, ankuesi është liruar nga detyra.

Komisioneri vlerëson se, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, z.F. G, i ka të ekspozuara dhe të provuara bindjet e tij të majta, si dhe aktivitetin e tij politik, si përfaqësues i forcës politike/Partisë Socialiste të Gjirokastrës, bazuar në sa më poshtë citojmë:

- Rezulton e provuar se ai ka mbajtur pozicionin e koordinatorit elektoral në zgjedhjet vendore të vitit 2015, për Bashkinë Libohovë, si përfaqësues i Partisë Socialiste.
- Ka mbajtur pozicionin e drejtuesit/kryetarit të Partisë Socialiste të Gjirokastrës, gjatë vitit 2016.
- Ka qenë deputet i Partisë Socialiste në Legjislaturën e IX të Kuvendit të Shqipërisë, dalë nga zgjedhjet e 25 Qershorit 2017.
- Është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë në Qershor 2019, funksion të cilin ushtron dhe aktualisht. Në zgjedhjet e 30 Qershorit 2019 është propozuar si kandidat për Bashkinë Gjirokastrë, nga forca politike, Partisë Socialiste¹⁶.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”.

Në kontekst të sa më sipër, ankuesi ka provuar se ka bindje politike të ndryshme nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm përse i takon masave disiplinore të dhëna ndaj tij, si dhe largimit të tij përfundimtar nga puna.

¹⁶ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al, Formularit të Vetëdeklarimit dhe CV-së së F.G.

Nga ana e Bashkisë Gjirokastër nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se procedura e ndjekur për dhënien e masave disiplinore apo largimin e ankuesit nga puna, kishte ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokolli 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹⁷

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja është shprehur se: *“...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësimit të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm”*. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës (KEDNJ)¹⁸.

¹⁷ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

¹⁸ “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁹ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit u ripohua si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s²⁰ që prej adoptimit në vitin 1998 të “Deklaratës së ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos këtë ratifikuar Konventat Themelore që parashtrajnë këto kritere.

Karta Sociale Europiane²¹ parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht”*.

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Karte do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”*.

Kodi i Punes, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*.

¹⁹ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

²⁰ International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

²¹ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁶. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10 221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Të provosh një çështje diskriminimi është e vështirë, pasi autorët e diskriminimit nuk deklarojnë se ata trajtojnë dikë në mënyrë më pak të favorshme se të tjerët, lidhur me një shkak të caktuar. Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *“praesumptio iuris tantum”*.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime *“ të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht²²”*.

²² GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Kodi i Procedurës Administrative, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Gjirokastrë, e cila duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²³ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Sa më sipër, personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek subjekti (nga i cili pretendohet diskriminimi), i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse diskriminuesi i pretenduar nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.²⁴

KMD bazuar në shqyrtimin e fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës dhe analizimit të legjislacionit përkatës; ka arritur në përfundimin që kemi të bëjmë me një trajtim të pafavorshëm të ankuesit nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

Përsa i përket bindjeve politike të subjektit ankues, bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që ai është anëtar i subjektit politik, Lëvizja Socialiste për Integritim.

Në analizë sa më sipër Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Bashkia Gjirokastrë kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Gjirokastrë duhet të përmbushte dy kushtet e përmendura më sipër.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike si anëtar i LSI-së dhe trajtimit të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

²³ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

- Që veprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk u arrit të provohej një përligje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të saj ndaj ankuesit, lidhur me masat disiplinore të dhëna ndaj tij dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të. Argumentimi i saj se largimi nga puna ka ardhur, pasi në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrat e ngarkuara nga ligji dhe Rregullorja e Brendshme e Agjencisë; rezulton i pa bazuar në prova, i padrejtë dhe i paligjshëm.

Në kushtet kur, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk u arrit të provohej që zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se qëndrimi i punëdhënësit ndaj tij ishte tendencioz dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 17, të Kodit të Procedurës Administrative, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, L. P, për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me L. P.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Bashkia Gjirokastrë të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindjet politike